

- Kërkesë e subjektit për dhënie me qira të pasurisë private;
 - Çertifikatë pronësie të pasurisë ose Vërtetim nga ASHK që është përfshirë në proces legalizimi;
 - Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë për sipërfaqen e ndërtesës.
- Dokumentacioni i konkurrentëve do të paraqitet:
 - Vendi: pranë Bashkisë Maliq
 - Data: 30.04.2024
 - Ora: 10:00

KRYETAR I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA JURIDIKE , BURIMET NJERËZORE DHE PROKURIMET PUBLIKE

Nr. 2200/1 Prot

Maliq më, 24.4.2024

NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 23, pika 12, VKM Nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3, date 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 215, datë 24.04.2024 “Për Fillimin e procedurës për marrje me qira ambjent për qendër ditore për fëmijë në qytetin e Maliqit”,

Bashkia Maliq, njofton se ka nisur procedurën për marrjen me qira të një ambjenti për qendër ditore për fëmijë në qytetin e Maliqit.

- Ambjenti që do merret me qira duhet të ketë kushtet si më poshtë:
 - Ambjenti që do të merret me qira të jetë në kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit përkatës;
 - Të jetë i furnizueshëm me ujë të pijshëm, energji elektrike dhe kanalizime të ujrave të zeza (në mungesë të tyre grope septike në gjëndje të mire për 24 orë, pa ndërprerje;
 - Të ketë ndriçim natyral në përputhje me standartet teknike dhe ekologjike, si dhe të ketë system ventilimi (ajrim natyral përmes dritareve), kondicionimi dhe ngrohje (të mos ketë lagështirë);
 - Ambjenti duhet të përmbajë brenda sipërfaqes së tij ambjent sanitar
 - Ambjenti duhet të jetë i vendosur në zone lehtësisht të aksesueshëm nga mjetet zjarrfikëse;
 - Sipërfaqja e ambjentit : 230 m2.
- Afati i marrjes me qira do të jetë për një periudhë 1 (një) vit.
- Konkurrentët e interesuar për dhënie me qira duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm: